



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 20 prot.

Tiranë, më 06. 01 . 2025

**V E N D I M**

**Nr. 06, datë 06. 01. 2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> shqyrtoi ankesën nr. 193 Regj., datë 16.09.2024, të z. G.B , kundër Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a<sup>3</sup>, me Nipt L72320033P, përfaqësuar nga Administratori z. E.K , me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës, aftësisë së kufizuar dhe qëndrimit të tij në burg.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi parashtron ndër të tjera se: “Unë G.B jam i datëlindjes 27.10.1977, banues në Tiranë pranë rrugës “Njazi Meka” dhe i përkas komunitetit rom. Jetoj i vetëm dhe jam i diagnostifikuar pre 25 vitesh me dëmtime pulmonare dhe trajtohem me KEMP, aftësi e kufizuar, niveli i tretë, i rëndë.”

Ankuesi thekson se, nga data 23.10.2023 deri më datë 22.05.2024, ka qenë i arrestuar në IEVP Fushë Krujë, për veprën penale “vjedhje”. Pasi mbaroi dënimin dhe u kthye shtëpi, ka konstatuar që UKT Tiranë i kishte faturuar vlera për periudhën e qëndrimit në burg dhe faturat kanë ardhur të

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri

<sup>3 3</sup> Në vijim do t’i referohemi si Shoqëria UKT sh.a

plota. Në lidhje me këtë problematikë, ankuesi deklaron se ka bërë ankesë pranë institucionit (UKT) duke i kërkuar anulimin e këtyre faturave.

Sa më sipër, ankuesi pretendon se për shkak të faktit që ai është anëtarë i komunitetit rom dhe të qëndrimit në burg, është diskriminuar nga ana e UKT sh.a, duke e faturuar për furnizimin me ujë.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminimin, të ndërhyjë për anulimin e faturave të furnizimit me ujë për periudhën që ai ka qenë duke vuajtur dënimin me burg dhe zgjidhjen e situatës.

Në datën 26.09.2024, ankuesi informoi Komisionerin se nga ana e UKT i është ndërprerë furnizimi me ujë, ndërkohë që nuk ka marrë ende një përgjigje për ankesën që ka paraqitur. Ankuesi parashtron se ai gjendet në kushte të vështira dhe jetesën e siguron vetëm nëpërmjet pagesës së aftësisë së kufizuar që përfiton nga Shërbimi Social Shtetëror.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në listë të hapur shkaqesh, duke ofruar shprehimisht mbrojtje nga diskriminimi, për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar, të pretenduar ndër të tjera nga ankuesi si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD, parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që

i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1280/1 prot., datë 09.10.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqërisë UKT sh.a, lidhur me pretendimet e ankuesit. Shoqëria UKT sh.a nuk ktheu përgjigje brenda 10 ditëve, afati ligjor për kthimin e përgjigjes, përcaktuar në nenin 33, pika 7, të LMD.
2. Në këto kushte, me shkresën nr. 1280/2 prot., datë 08.11.2024, Komisioneri kërkoi në mënyrë të përsëritur vendosjen në dispozicion nga ana e këtij subjekti, të informacionin të nevojshëm të kërkuar për shqyrtimin e ankesës.

Në vijim të kësja kërkesë, me shkresën nr. K2415/2 prot., datë 15.11.2024, Shoqëria UKT sh.a ktheu përgjigje, duke informuar si më poshtë vijon:

Kontrata nr.005823-1 rezulton e regjistruar në SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) në emër të z.G.Z.B, për objektin në rrugën “Njazi Meka” dhe rezulton me detyrime të palikujduara në shumën totale 28, 836.00 lekë deri në datën 13.11.2024. Kjo kontratë është hapur në vitin 1997 në emër të znj.H.M. Në korrik të vitit 2015, z.G.B ka kërkuar ndryshimin e emrit të kontratës nr.005823-1 nga znj.Hatixhe Mersini në emër të z.G.B .

Në datën 17.09.2024, është ndërprerë linja e furnizimit me ujë të pishëm nga ana e Njësisë Zonale nr.1, pasi abonenti rezultonte debitor (proces-verbali dhe foto bashkëlidhur). Në datën 27.09.2024, abonenti ka lidhur Akt-marrëveshje me UKT sh.a për shlyerjen me këste të detyrimit të akumuluar.

Prej muajit mars 2021, ky abonet është përjashtuar nga pagesa e taksave dhe tarifave vendore, të përfshira në faturën mujore të konsumimit të ujit.

3. Në datën 26.11.2024, ankuesi ka depozituar në protokollin e Komisionerit, kërkesën me nr. 1280/4 prot., nëpërmjet të cilës kërkon që të tërhiqet nga ankesa dhe Komisioneri të mos vijojë me shqyrtimin e saj, pasi nga ana e UKT sh.a ishte bërë rilidhja e ujit dhe në këto kushte problematika e tij ishte zgjidhur.

Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ka filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura

*administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi G.B , i cili me anë të kërkesës, datë 26.11.2024 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Në kërkesën për tërheqje nga ankuesi, gjithashtu i ka kërkuar Komisionerit që të rekomandojë UKT sh.a, që të rishikojë këstin e përcaktuar në Akt-Marrëveshjen me UKT sh.a për shlyerjen me këste të detyrimit të akumuluar, të nënshkruar më datë 27.09.2024, pasi ai ndodhet në pamundësi financiare për të respektuar dhe shlyer detyrimet, sipas marrëveshjes së dakortësuar me UKT sh.a.

Në bazë të nenit 21, të LMD, Komisioneri është një institucion i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “f”, të LMD, Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë autoriteteve kompetente rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin.

Me qëllim parandalimin në të ardhmen të çdo situatë që nxit diskriminimin, si dhe bazuar në kompetencën ligjore që Komisioneri ka për t’u bërë autoriteteve kompetente rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, Komisioneri rekomandon si më poshtë:

Nga aktet e administruara, rezulton se ankuesi G.B , i datëlindjes 27.10.1977 dhe bazuar në vendimin e Komisionit Shumëdisiplinor, është vlerësuar si person me aftësi të kufizuara, Niveli 3 (i rëndë), me afat vlefshmërie 01.07.2024 – 01.07.2026. Për periudhën, nga data 23.10.2023 deri më datë 22.05.2024, ai ka qenë i arrestuar në I EVP Fushë Krujë, për kryerjen e një veprë penale. Pas kryerjes së dënimit ankuesi është rikthyer në banesën e tij, në rrugën Njazi Meka, në Tiranë. Në datën 17.09.2024, ankuesit i është ndërprerë linja e furnizimit me ujë të pishëm nga ana e Njësisë Zonale nr.1, të UKT sh.a, pasi rezultonte debitor në shumën. Nga data 17.09.2024 deri në datën 27.09.2024, datë në të cilën është lidhur Akt-Marrëveshja midis UKT sh.a ankuesit, ky i fundit nuk ka patur furnizim me ujë të pishëm në banesën e tij.

Referuar Akt Marrëveshjes së datës 27.09.2024, rezulton se ankuesi do të shlyejë nëpërmjet kësteve mujore debinë në shumën 29282.26 lekë dhe kësti mujor do të jetë 5,000 lekë në muaj. Specifikisht në pjesën hyrëse të kësaj akt marrëveshje citohet se ajo po lidhet midis palëve meqënëse ekzistojnë këto kushte:

- *Kontraktuesi ndodhet në pamundësi financiare për të paguar detyrimin të total;*
- *Kontraktuesi njih dhe pranon detyrimin që ka ndaj UKT sh.a për konsumin e ujit;*
- *UKT sh.a, referuar nenit 459 të Kodit Civil dhe ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, udhëzimeve të ERRU, ndjek politika tregtare, për krijimin e kushteve që konsumatorët në vështirësi ekonomike, të ruajnë të drejtën e tyre për përdorimin e shërbimeve publike, jetike në vazhdimësi.*

Në nenin 4 “Zgjidhja e Akt Marrëveshjes”, të Akt Marrëveshjes së datës 27.09.2024, përcaktohet se: “4.2 Në rast se konsumatori nuk respekton afatet e vendosura për pagesën e dy prej kësteve të para, kjo akt marrëveshje do të konsiderohet e zgjidhur automatikisht dhe konsumatori është i detyruar të likujdojë të gjithë detyrimin në total.”

Kushtetuta e republikës së Shqipërisë, sanksionon se, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. (Neni 3, i Kushtetutës)

E drejta e njeriut për ujë, është e domosdoshme për të jetuar një jetë me dinjitet dhe është parakusht për realizimin e të drejtave të tjera të njeriut. Një sasi e mjaftueshme e ujit të sigurt, është e nevojshme për të parandaluar vdekjen nga dehidratimi, për të zvogëluar rrezikun e sëmundjeve të lidhura me ujin dhe për të siguruar konsumin, gatimin, kërkesat higjienike personale dhe shtëpiake.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në nenin 11 sanksionohet e drejta për një standard të përshtatshëm jetese, ndër në nenin 12, e drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit. Konkretisht, në paragrafët 1, të nenit 11 dhe 12, të këtij Pakti sanksionohet: “(neni 12 (1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin të përshtatshëm si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. .... (Neni 12(1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë.”

E drejta për ujë hyn qartë në kategorinë e garancive thelbësore për sigurimin e një standardi të përshtatshëm jetese, veçanërisht pasi ajo është një nga kushtet më themelore për mbijetesë. E drejta për ujë është gjithashtu e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit (neni 12, paragrafi 1 i Paktit) dhe të drejtat për strehim të përshtatshëm dhe ushqim të përshtatshëm.(neni 11, paragrafi 1 i Paktit)

E drejta për ujë është njohur në një sërë dokumentesh ndërkombëtare. Për shembull, neni 14, paragrafi 2, i Konventës së OKB-së Për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave parashikon që Shtetet palë do t'u sigurojnë grave të drejtën për të "gëzuar kushte të

*përshtatshme jetese, veçanërisht në lidhje me furnizimin me ujë". Neni 24, paragrafi 2, i Konventës së OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve, u kërkon shteteve palë të luftojnë sëmundjet dhe kequshqyerjen "nëpërmjet ofrimit të ushqimeve të duhura ushqyese dhe ujit të pijshëm të pastër".*

Konventa e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", në nenin 28 "Standardi i përshtatshëm i jetesës dhe mbrojtja shoqërore", përcakton : "1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese për ta dhe për familjet e tyre, përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar.

2. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për mbrojtje shoqërore, dhe që ata ta gëzojnë atë të drejtë pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar dhe duhet të marrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte, përfshirë masat:

a) Për t'u siguruar mundësim të barabartë personave me aftësi të kufizuara ndaj shërbimeve për ujë të pastër dhe për të siguruar mundësimin e shërbimeve, pajisjeve dhe formave të tjera të asistencës të përshtatshme dhe të përballueshme për nevoja të lidhura me aftësinë e kufizuar;"

Në Komentin e Përgjithshëm Nr.15 (2002) "E drejta për ujë", Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor, në cilësinë e autoritetit i cili monitoron dhe interpreton Paktin, ofron udhëzime në lidhje me çështje thelbësore që lidhen me zbatimin e neneve 11 dhe 12, të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Disa prej këtyre udhëzimeve, të cilat Komisioneri vlerëson se gjejnë zbatim në çështjen objekt shqyrtimi janë pasqyruar si më poshtë:

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor, në Komentin e Përgjithshëm Nr.15 (2002) "E drejta për ujë" thekson se: "E drejta e njeriut për ujë, i jep të drejtë të gjithë personave për ujë të mjaftueshëm, të sigurt, të pranueshëm, fizikisht të aksesueshëm dhe të përballueshëm për përdorim personal dhe shtëpiak."

E drejta për ujë përmban liri dhe të drejta. Liritë përfshijnë të drejtën për të ruajtur aksesin në furnizimet ekzistuese të ujit të nevojshme për të drejtën për ujë, dhe të drejtën për të qenë i lirë nga ndërhyrjet, siç është e drejta për të qenë i lirë nga shkëputjet arbitrare ose ndotja e furnizimeve me ujë. Të drejtat përfshijnë edhe të drejtën për një sistem të furnizimit dhe menaxhimit të ujit që ofron mundësi të barabarta për njerëzit që të gëzojnë të drejtën e ujit. Elementet e së drejtës për ujë duhet të jenë të përshtatshme për dinjitetin, jetën dhe shëndetin e njeriut. Përshtatshmëria e ujit nuk duhet të interpretohet ngushtë, thjesht duke iu referuar sasive dhe teknologjive vëllimore. Uji duhet trajtuar si një e mirë sociale dhe kulturore dhe jo të shihet kryesisht si një e mirë ekonomike.

Ndërsa përshtatshmëria e ujit që kërkohet për të drejtën për ujë mund të ndryshojë sipas kushteve të ndryshme, faktorët e mëposhtëm zbatohen në të gjitha rrethanat:

- (a) *Disponueshmëria*. Furnizimi me ujë për çdo person duhet të jetë i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm për përdorime personale dhe shtëpiake. Këto përdorime zakonisht përfshijnë pirjen, kanalizimet personale, larjen e rrobave, përgatitjen e ushqimit, higjenën personale dhe shtëpiake. Sasia e ujit në dispozicion për çdo person duhet të korrespondojë me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Disa individë dhe grupe mund të kërkojnë gjithashtu ujë shtesë për shkak të shëndetit, klimës dhe kushteve të punës;
- (b) *Cilësia*. Uji i nevojshëm për çdo përdorim personal ose shtëpiak duhet të jetë i sigurt, pa mikroorganizma, substanca kimike dhe rreziqe radiologjike që përbëjnë një kërcënim për shëndetin e një personi. Për më tepër, uji duhet të jetë i një ngjyre, ere dhe shije të pranueshme për secilin përdorim, personal ose shtëpiak.
- (c) *Aksesueshmëria*. Uji dhe objektet e shërbimit e ujit duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë pa diskriminim, brenda juridiksionit të shtetit palë. Aksesueshmëria ka katër dimensionet e mëposhtme:
  - (i) *Aksesueshmëria fizike*: uji dhe objektet e shërbimit e përshtatshme të ujit, duhet të jenë brenda mundësive të sigurta fizike për të gjitha shtresat e popullsisë. Uji i mjaftueshëm, i sigurt dhe i pranueshëm duhet të jetë i aksesueshëm brenda ose në afërsi të çdo familjeje, institucioni arsimor dhe vendit të punës. Të gjitha objektet dhe shërbimet e ujit duhet të jenë të cilësisë së mjaftueshme, të përshtatshme nga ana kulturore dhe të ndjeshme ndaj kërkesave gjinore, ciklit jetësor dhe privatësisë. Siguria fizike nuk duhet të jetë kërcënuar gjatë aksesit në objektet dhe shërbimet ujore;
  - (ii) *Aksesueshmëria ekonomike*: Uji dhe objektet e shërbimit e ujit duhet të jenë të përballueshme për të gjithë. Kostot dhe tarifat direkte dhe indirekte që lidhen me sigurimin e ujit duhet të jenë të përballueshme dhe nuk duhet të rrezikojnë ose kërcënojnë realizimin e të drejtave të tjera të Paktit;
  - (iii) *Mosdiskriminimi*: Uji dhe objektet e shërbimit e ujit, duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë, duke përfshirë shtresat më të cenueshme ose më të marginalizuara të popullsisë, në ligj (*de jure*) dhe në fakt (*de facto*), pa diskriminim për asnjë nga shkaqet e ndaluara; dhe
  - (iv) *Aksesueshmëria në informacion*: aksesueshmëria përfshin të drejtën për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion në lidhje me çështjet e ujit.

Shtetet palë kanë një detyrim të veçantë për t'u siguruar atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme, ujin dhe pajisjet e nevojshme, për të parandaluar çdo diskriminim, bazuar në shkaqet e ndaluara/mbrojtura. Ndërsa e drejta për ujë vlen për të gjithë, shtetet palë duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë atyre individëve dhe grupeve që tradicionalisht janë përballur me vështirësi në ushtrimin e kësaj të drejte, duke përfshirë, minoritetet apo personat me aftësi të kufizuara.

Ndërsa Pakti parashikon realizimin progresiv dhe pranon kufizimet për shkak të kufijve të burimeve të disponueshme, ai gjithashtu u imponon shteteve palë detyrime që kanë efekt të menjëhershëm. Shtetet palë kanë detyrime të menjëhershme në lidhje me të drejtën për ujë, të tilla si, garancia që e drejta do të ushtrohet pa asnjë lloj diskriminimi dhe detyrimi për të ndërmarrë hapa drejt realizimit të plotë. Komiteti, ka identifikuar një sërë detyrimesh thelbësore në lidhje me të drejtën për ujë, të cilat kanë efekt të menjëhershëm, ku ndër të tjera përfshihen:

- Të sigurojë sasinë minimale thelbësore të ujit, e cila është e mjaftueshme dhe e sigurt për përdorime personale dhe shtëpiake për të parandaluar sëmundjet;
- Të sigurojë të drejtën e aksesit për ujë dhe në objektet dhe shërbimet e ujit mbi baza jodiskriminuese, veçanërisht për grupet e pafavorizuara ose të marginalizuara;
- Të miratojë programe të synuara me kosto të ulët për të mbrojtur grupet e cenueshme dhe të marginalizuara;

Duhet të theksohet se një shtet palë nuk mund të justifikojë mospërputhjen e tij me detyrimet thelbësore, të cilat janë të paderogueshme.

E drejta për ujë, si çdo e drejtë e njeriut, imponon tre lloje detyrimesh për shtetet palë: *detyrimet për të respektuar, detyrimet për të mbrojtur dhe detyrimet për të përmbushur*.

*Detyrimi për të respektuar* kërkon që shtetet palë të përmbahen nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në gëzimin e të drejtës për ujë. Detyrimi përfshin, ndër të tjera, mospërfshirjen nga çdo praktikë ose aktivitet që mohon ose kufizon e aksesin e barabartë në ujë të mjaftueshëm.

*Detyrimi për të mbrojtur* kërkon që shtetet palë të parandalojnë palët e treta që të ndërhyjnë në çfarëdo mënyre në gëzimin e të drejtës për ujë.

*Detyrimi për të përmbushur* mund të ndahet në *detyrimet për të lehtësuar, promovuar dhe siguruar*. *Detyrimi për të lehtësuar* kërkon që shteti të marrë masa pozitive për të ndihmuar individët dhe komunitetet që të gëzojnë të drejtën. *Detyrimi për të promovuar* detyron shtetin palë të ndërmarrë hapa për të siguruar edukimin e duhur në lidhje me përdorimin higjienik të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore dhe metodat për të minimizuar humbjen e ujit. Shtetet palë janë gjithashtu të detyruara të përmbushin (*sigurojnë*) të drejtën kur individët ose një grup nuk janë në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojnë vetë këtë të drejtë me mjetet që kanë në dispozicion.

Duke ju rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, si dhe bazuar në standardet e mësipërme sipas të cilave duhet të sigurohet e drejta e njeriut për ujë, Komisioneri vlerëson se:

Në bazë të nenit 23 “*Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike*”, të ligjit Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, të ndryshuar, përcaktohet se, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre, ndër të tjera për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, është një shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar. Megjithatë, ajo është një shoqëri e cila, referuar ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në pronësi të Bashkisë Tiranë, si aksionar i vetëm i kësaj shoqërie.

Bashkia Tiranë, e cila në bazë të nenit 23, të ligjit nr. Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, të ndryshuar, është përgjegjëse për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të



pijshtëm, të qytetarëve që jetojnë në juridiksionin e saj e ushtron këtë funksion të saj nëpërmjet persot juridik Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. Në këtë mënyrë marrëdhënia e krijuar midis ankuesit dhe Shoqërisë Ujësjetllës kanalizime Tiranë sh.a është një marrëdhënie midis individit dhe një autoriteti publik/shtetit.

*Në radhë të parë*, është e papranueshme dhe një praktikë e cila duhet shmangur, ndërprerja e furnizimit me ujë, duke mohuar plotësisht aksesin në ujë për kategoritë vulnerabël sikurse në rastin konkret është ankuesi, i cili është një person me aftësi të kufizuara apo individëve ose një grup i individësh, që nuk janë në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojnë vetë këtë të drejtë me mjetet që kanë në dispozicion, pa siguruar sasinë minimale thelbësore të ujit, e cila është e mjaftueshme dhe e sigurt për përdorime personale dhe shtëpiake për të parandaluar sëmundjet.

*Në radhë të dytë*, Komisioneri konstaton se, skema e akt marrëveshjes e zbatuar në rastin e ankuesit, në kushtet në të cilat gjendet ankuesi nuk është efektive. Komisioneri arrin në këtë përfundim duke konstatuar se, vlera e kështit mujor prej 5 000 (pesë mijë)lekë në muaj (duke i shtuar vlerën e faturës koherente të muajit përkatës) që ankuesi duhet të paguajë për të shlyer detyrimet e prapambetura, të cilat ishin bërë shkak për ndërprerjen e furnizimit me ujë, nuk është e përmballueshme ekonomikisht, në kushtet kur ankuesi ka si burim të ardhurash vetëm pagesën e aftësisë së kufizuar. Në rast të mosrespektimit të akt marrëveshjes nga ana e ankuesit, për shkak të pamundësisë ekonomike për të shlyer kështin mujor prej 5 000 (pesë mijë) lekë, ankuesi mund të vendoset sërish në kushtet kur mundt'i mohohet aksesin në furnizimin me ujë të pishëm. Pavarësisht aplikimit të kësaj skeme lehtësuese, në kushtet në të cilat ndodhet ankuesi, kështi mujor prej 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, i përcaktuar në akt marrëveshjen e datës 27.09.2024, kjo skemë lehtësuese nuk është efektive.

Bazuar në kompetencën që ligji i ka dhënë Komisionerit për t'u bërë autoriteteve publike çdo lloj rekomandimi që ka të bëjë luftimin dhe parandalimin e diskriminimit si dhe bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri rekomandon Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, që të ndalojë aplikimin e praktikës së ndërprerjes së furnizimit me ujë për shkak të mospagesës së detyrimeve nga ana e klientëve, për individët ose grupet e individëve vulnerabël, ku përfshihen edhe personat me aftësi të kufizua, si dhe për personat ose grupet e personave të cilët për shkak të gjendjes ekonomike janë në pamundësi financiare për të shlyer detyrimin, sikurse janë personat që përfitojnë ndihmë ekonomike. Në lidhje me rastin e ankuesit, Komisioneri rekomandon Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a që të rishikojë Akt Marrëveshjen e datës 27.09.2024 të lidhur me ankuesin, duke zvogëluar kështin mujor që ankuesi është i detyruar të paguar për shlyerjen e detyrimit të prapambetur, në atë masë që të jetë e përballueshme nga ana e ankuesit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 193 Regj., datë 16.09.2024, të paraqitur nga z.G.B , pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Rekomandohet Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese në lidhje garantimin e të drejtës për ujë, me gjatë ushtrimin të veprimtarisë së saj, të marrë masat e mëposhtme:
  - 2.1 Të rishikojë Akt Marrëveshjen e datës 27.09.2024 të lidhur me z. G.B , duke zvogëluar këstin mujor në atë masë që të jetë i përballueshëm nga ana e ankuesit.
  - 2.2 Të marrë masa për të ndaluar çdo praktikë të ndërprerjes së furnizimit me ujë për shkak të mospagesës së detyrimeve nga ana e klientëve që i përkasin kategorive vulnerabël, sikurse janë personat me aftësi të kufizuara, si dhe klientëve të cilët për shkak të gjendjes ekonomike janë në pamundësi financiare për të shlyer detyrimin, sikurse janë personat që janë përfitues të ndihmës ekonomike nga Shteti.
3. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Raca, aftësia e kufizuar, çdo shkak tjetër\_qëndrimi në burg.  
Fusha: Shërbime  
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti+Rekomandim